

KËRKESË ANKIMORE

Drejtuar: Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS)
në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Ndërtesa nr.4: Tiranë



Ora: 18:50

ANKUESI

Subjekti Ankues	Adresa, posta elektronike dhe/ose nr. i telefonit Tel : 0697839115 / 0696178916
KOALICIONI "BASHKË FITOJMË" - BF	

OBJEKTI I ANKIMIT

- Kundërshtimin e Vendimit Nr. 536, datë 20.05.2023 "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në Zonën Zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023" ;**
- Ekspertimin kompjuterik të çdo pajisjeje elektronike që është e pajisur me server për ruajtjen e të dhënave elektronike. Kjo të realizohet nga ekspertë të huaj të pavarur nga institucionet shtetërore apo Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Për këtë nevojitet që pajisjet të ruhen në kushte të përshtatshme në gjendjen aktuale me qëllim mosndërhyrjen nga personat e paautorizuar si dhe të mirëruajtura nga agjentët atmosferikë.**
- Krahasimin e rezultatit elektronik të zgjedhjeve me rezultatit fizik (fletëve të votimit të gjendura në kuti) për çdo qendër votimi. Për këtë kërkohet një process sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.**
- Kqyrjen e kamerave të jashtme dhe të atyre të përdorura brenda qendrave të votimit me qëllim evidentimin e të gjithë personave të paautorizuar apo pjesë e administratës vendore dhe qendrore në nivel specialist apo drejtuesi, që kanë qënë gjatë gjithë kohës nëpër qendra votimi, evidentimin e mosnënshkrimit të deklaratave përkatëse për votuesit që janë shoqëruar, evidentimin e votimit nga vetë Operatorët e PEVN-ve, evidentimin e votimit të komisionerëve për llogari të votuesve.**
- Krahasimin e kodeve të votuesve me listen e votuesve për çdo QV në Bashkinë Kamëz, në lidhje me pajisjen e identifikimit të votuesve (PEI).**
- Rinumërimin dhe Rivlerësimin e votave në të gjitha qendrat e votimit të njësisë zgjedhore, Bashkia Kamëz dhe miratim i tabelës përmbledhëse për zonën zgjedhore Bashkia Kamëz duke përfshirë në të rezultatit e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave;**
- Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz; si dhe**
- Së fundmi, pasi të jenë kryer veprimet e mësipërme dhe të keni krijuar bindjen Tuaj institucionale se kjo nuk është vota e qytarëve, nga ana Juaj kërkohet:**

Përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar të bashkisë si dhe të Këshillit Bashkiak Kamëz



me anë të votimit tradicional me fletë votimi dhe me garanci të plota për një process të rregullt.	
Vendimi	<u>TITULLI I VENDIMIT</u> <u>“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në Zonën Zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023”.</u>
Nr.	Datë
536	20.05.2023
<p>1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kamëz, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.</p> <p>2. Shpalljen fitues të z. Rakip Suli , si Kryetar i Bashkisë Kamëz, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.</p> <p>3. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Kamëz, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.</p> <p>4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.</p> <p>5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.</p>	
Baza Ligjore:	
<p>Nenet: Nenet 1, 4/1, 18, 35, 45 dhe 64 të Kushtetutës së Shqipërisë; Neni 6/1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; Pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore; Nenet 12, pika 4; 21, pika 1; 33, gërma “ë”; 91; 92; 98, pika 4; 106, pika 1; 113, pika 1; 116, pikat 6/7; 116/1, pika 5; 117, pika 2/3/4; 118, pika 1/2; 122, pika 2/5; 123, pika 4; 123/1, pikat 1 dhe 2; 124, pikat 1 dhe 3; 143, pika 1, gërmat “ç” dhe “d”; 160, pika 1, gërma “a” dhe 2; 161, pika 1 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar; Neni 2 i ligjit 138/2015.</p>	

NË LIDHJE ME PROCEDURËN DHE KONTESTIMIN

A. Në lidhje me legjitimitimin e palës ankuese

Neni 123/1, pika 1 e Kodit Zgjedhor parashikon se KQZ-ja vihet në lëvizje me kërkesë të subjekteve zgjedhore në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së. Ndërsa, neni 124, pika 1 dhe 3 parashikojnë se çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së që çenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit. Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, mund të paraqitet ankim po në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi.



Me Vendimin Nr. 179, datë 18.03.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur të regjistrojë si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023, Koalicionin “Bashkë Fitojmë”, me Kryetar z. Ilir Metaj, me shkronjat nistore “BF”.

B. Në lidhje me kompetencën e organit administrativ

Neni 12, pika 5 e Kodit Zgjedhor parashikon se Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim “KAS”) është organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative. Neni 21, pika 1, gërma “a” parashikon se KAS-i vendos për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në një ose më shumë zona zgjedhore apo në të gjithë vendin, si dhe përsëritjen e pjeshme ose të plotë të zgjedhjeve. Ndërsa, neni 123, pika 5 parashikon se vendimet për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit Zgjedhor ankimohen në KAS.

Me Vendimin Nr. 536, date 20.05.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për kandidatët për kryetar Bashkia dhe për këshillin Bashkiak, Bashkia Kamëz. Në zbatim të nenit 12, pika 5, neni 21, pika 1, gërma “a” dhe neni 123, pika 5 e Kodit Zgjedhor, çdo subjekt zgjedhor, i legjitimuar sipas parashtrimeve në paragrafët 11 – 13, ka të drejtë të paraqesë ankim kundër vendimit të KQZ për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultatit zgjedhor në KAS, brenda afatit ligjor. Në këtë kuptim, Koalicioni “BF” përmbush kriterin e dytë procedural, kompetencën lëndore, për shqyrtimin e këtij ankimi.

C. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit

Kriteri i tretë për paraqitjen e një ankimi administrativ kundër vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit Zgjedhor ka të bëjë me afatin ligjor të ankimit. Për këtë, neni 152, pika 2 i Kodit Zgjedhor ka parashikuar një afat të përgjithshëm ankimi 5-ditor kundër të gjitha vendimeve të marra nga KQZ-ja në periudhën 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve deri në përfundimin e shqyrtimit administrativ të ankimeve. Ndërsa, neni 124, pika 3 ka parashikuar shprehimisht që kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhës të Rezultatit në për kandidatët për Kryetar Bashkia Kamëz mund të bëhet jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi.

Në rastin konkret, vendimi Nr. 536 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është shpallur në datën 20.05.2023. Për respektimin e afatit ligjor, subjekti zgjedhor duhet të paraqesë një ankim jo më vonë se data 25.05.2023. Ankimi është paraqitur brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 152, pika 2 dhe 124, pika 3 të Kodit Zgjedhor. Në këtë kuptim, Koalicioni “BF” përmbush kriterin e tretë procedural, afatin ligjor, për paraqitjen e këtij ankimi.



Konkluzion: Neni 130 i Kodit Zgjedhor përcakton se KQZ merr vendim për pranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon: a) kompetencën e KQZ-së; b) legjitimitimin e ankuesit; dhe c) respektimin e afateve ligjore. Duke qenë se siç e kemi shpjeguar më lart, ankimi i paraqitur nga Koalicioni “BF” përmbush të tre kriteret procedurale (*legjitimitimin, kompetencën dhe*

afatin ligjor), kërkojmë pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve.

PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Duke qenë se jemi të bindur, bazuar në prova dhe fakte të pakundërshtueshme, se periudha para dhe zgjedhore u shoqërua me shkelje të ligjit, të cilat cënuan rëndë procesin zgjedhor në një masë të tillë që ndikoi drejtpërdrejtë në ndarjen e mandatit, në vijim do të parashtrojmë faktet që mbështesin këtë pretendim:

Në datën 20.05.2023, kemi marrë dijeni për Vendimin Nr. 536, datë 20.05.2023 të KSHZ objekt anklimi.

Koalicioni Bashkë Fitojmë, ndër të tjera edhe nëpërmjet kandidatit tonë z. Arjan Hoxha, ka ardhur në dijeni të fakteve, indicieve dhe ka siguruar prova të mjaftueshme lidhur me problematika dhe parregullsi të procesit zgjedhor të ndodhura në Bashkinë Kamëz.

Duke mos qenë dakord me këtë vendim, për shkak se vlerësojmë se gjatë procesit zgjedhor prej të cilit ka dalë ky vendim kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor, si dhe tërësia e shkeljeve të ligjit, të ndodhura në këtë zonë zgjedhore ka cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që ka ndikuar në rezultatin final, siç do të provohen gjatë hetimit administrativ, po parashtrojmë këtë ankim me faktet, dispozitat ligjore dhe arsyetimin ligjor, si më poshtë:

KONTESTIMET DHE PROBLEMATIKAT E PAJISJES ELEKTRONIKE TË VOTIMIT E NUMËRIMIT SI DHE PROCESIT ZGJEDHOR NË TËRËSI PËR KZAZ-TË 27 DHE 28, BASHKIA KAMËZ:

Me datë 14.04.2023, si në gjithë territorin e Shqipërisë edhe në bashkinë Kamëz u zhvilluan zgjedhjet për Kryetarët e bashkive dhe për Këshillat Bashkiak.

Në KZAZ-të 27 dhe 28 që i përkasin bashkisë Kamëz, janë konstatuar, problemet si më poshtë:

- Problemi themelor i cili ka tjetërsuar në mënyrë masive votën e qytetarëve të Kamzës e Paskuqanit, është programimi paraprak i rezultatit të zgjedhjeve vendore me anë të **Pajisjes Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN)**. Ka raste të denoncuar pranë Shtabit Elektorale të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, si:
 1. Është votuar për numrin rendor “3” dhe fleta e votimit është printuar me numër rendor “1”. Për këtë kemi disa raste të kostatuara dhe për njërin është faktuar në QV 1600 (Shkolla 100-vjetori në Kamëz).
 2. Në rastet e votimit për kandidatin e “BF” **z. Arjan Hoxha**, kishte vonesa të pashpjegueshme në kohë të kryerjes së procesit të votimit elektronik nga pajisja PEVN;



3. Pranë shtabit elektoral të “BF”, kanë ardhur denoncime të panumërta nga votuesit për moskryerjen deri në fund të procesit të votimit, pasi nuk merrte komandën e dhënë nga votuesi te rubrika “printo”, pavarësisht komandës së dhënë. Në këto raste nga ana e komisionerëve dhe operatorëve përkatës përgjigja ka qënë e njëjtë në çdo QV, duke iu thënë: largohuni se keni kryer procesin e votimit, ndërkohë që ky proces nuk kishte përfunduar, duke bërë të mundur që operatorët të përfundonin procesin e votimit sipas orientimeve politike, në rastet e mësipërme të dhëna nga drejtuesit e administratës vendore të bashkisë Kamëz, apo të drejtuesve të administratës qëndrore;
4. Fakt tjetër i pakundërshtueshëm është ulja e numrit të votave për kandidatin e “BF” në mënyrë drastike, krejt të pashpjegueshme si dhe në mënyrë progresive për çdo QV, në krahasim me të gjitha proceset e votimit ndër vitë në Kamëz dhe Paskuqan. Nga një analizë krejt e thjeshtë e këtij fenomeni, jo vetëm në Kamëz e Paskuqan, por në gjithë Shqipërinë nuk mund të ndodhë që një kandidat të humbë në çdo QV, gjë e cila tregon që programimi i sistemit të votimit elektronik, ka paracaktuar në përqindje ose me numër “klikimesh” fituesin;
5. Operatorët e caktuar në Qendrat e Votimit, pavarësisht konkurimit të qindra të rinjve, janë përzgjedhur ata të cilët ishin në kundërshtim me pikën 12 për kriteret e kësaj detyre, e cila përcakton se: “Operatori nuk duhet të jetë në marrëdhënie pune më ndonjë nga kandidatët që kandidon në zonën zgjedhore ku ndodhet qendra e votimit në të cilën je caktuar si operator teknik”. Operatorët në masë ishin edhe familjarë të punonjësve të administratës dhe të kryetarëve të organizatave të Partisë Socialiste.

- **Problem tjetër** i konstatuar dhe që ka ndikuar në rezultat është shoqërimi i votuesve nga ana e Komisionerëve, Operatorëve të QV-ve, punonjësve të administratës vendore e qëndrore dhe votimi është kryer në emër të tyre, fenomen i cili ka qënë masiv dhe në çdo Qendër Votimi. Kemi QV, në të cilat votimi me shoqërues, është kryer në masën 50% e pjesëmarrësve në votim.
- Edhe kur votuesi është shoqëruar për të votuar, në shumicën absolute nuk janë nënshkruar deklaratat përkatëse sipas Kodit Zgjedhor, gjë e cila është bërë me qëllimin e vetëm që nje person të shoqëronte shumë votues.
- Blerja masive e votës siç u vërtetua që në fushatë nga media ku administrator i njësisë Paskuqan mblidhte karta të simpatizantëve të koalicionit “Bashkë Fitojmë” kundrejt shumëve monetare me qëllim që të mos marrë pjesë në votim.
- U vërtetua me video se disa ditë para zgjedhjeve punonjës të ASHK, shkonin shtëpi në shtëpi për të ofruar legalizimin në këmbim të votës.
- Presioni i vazhdueshëm ndaj votuesve, intimidimi i tyre dhe shoqërimi në afërsi të QV-ve deri tek Komisioni i QV-së nga ana e drejtuesve dhe punonjësve të administratës vendore dhe qëndrore si edhe personave të tjerë mbështetës të kandidatit të PS-së Rakip Suli, ka qënë një fenomen që ka ndodhur gjatë gjithë procesit të votimit nga ora 07.00 deri në ora 19.00. Për këtë kemi fakte, prova dhe emra konkretë dhe nga ana jonë do ndiqet rruga ligjore deri në kallzim penal.
- Përdorja e bizneseve VIP dhe e bizneseve në përgjithësi, para dhe gjatë procesit të votimit duke iu kërkuar me detyrim votat e punonjësve të tyre, duke iu caktuar zona patronazhimi me qëllim kontrollimin dhe intimidimin e votuesve, apo duke i caktuar



edhe si komisionerë ose vëzhgues ditën e zgjedhjeve, kuptohet me qëllimin e vetëm për të kontrolluar votat e votuesve të blerë.

- Mosfunksionimi deri në tre orë i pajisjeve identifikuesve, duke ndikuar në largimin e një numri të madh zgjedhësish pa votuar.
- Punonjësit e administratës kanë qënë në çdo qendër votimi. Bashkangjitur tabela përkatëse me emrat e këtyre punonjësve sipas qendrave votimi.
- Në listat përfundimtare të zgjedhësve, është bërë ndryshimi i qendrave të votimit pa asnjë arsye për një numër të madh zgjedhësish krahasuar me zgjedhjet pararendëse, është ndarë një familjeje në dy qendra votimi, pavarësisht adresës së njëjtë të banimit.

Nuk mund të lihet pa vënë në dukje që asfalti elektoral pushtoi territorin e bashkisë Kamëz, pa u kryer as edhe një procedurë prokurimi publik, pa u vendosur asnjë tabelë që tregon punimet që do kryehen, nga kush financohet apo nga cili operator ekonomik do të kryhet; premtimet apo leglizimet duke u shpërndarë lejet e legalizimeve deri një natë para ditës së zgjedhjeve; emërimet tre mujore pak ditë përpara ditës së zgjedhjeve;

Pavarësisht fakteve e rrethanave që cituam më lart, të cilat absolutisht kanë ndikimin e tyre në rezultatin e zgjedhjeve të datës 14.05.2023, ajo që ne e konsiderojmë faktorin kyç të masakrës zgjedhore dhe deformimit në mënyrë drastike dhe krejt të pashpjegueshme të rezultatit të zgjedhjeve për Kamzën e Paskuqanin, është programimi i rezultatit të zgjedhjeve vendore me anë të **Pajisjes Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN)**.

Gjithshtu, vlen të theksojmë edhe faktin se në çdo qendër votimi një numeri konsiderueshëm pesonash (madje në disa QV, mbi 50% të votuesve) rezultojnë se kanë votuar me shoqërim / të shoqëruar, në shumicën e rasteve pa plotësuar deklaratat perkatese. Në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore, shoqëruarit nuk kanë shoqëruar vetëm një person (sic kërkohej nga ligji) por rezultojnë se kanë shoqëruar me dhjetra individë për të votuar. Kjo është padyshim ndikim në zgjedhje dhe shkelje e procesit të fshehtë dhe të lirë të zgjedhjeve që kanë ndodhur në Kamëz.

FAKTET, ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBËSHTETET ANKIMIMI.

Të gjitha faktet, indicjet dhe provat në disponimin tonë, provojnë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme se kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor (madje në disa raste këto shkelje përbëjnë krim zgjedhor) dhe konkretisht:

Të nderuar anëtar të KAS, subjekti zgjedhor dhe njëkohësisht me cilësinë e ankuesit brenda periudhës së ngushtë në dispozicion për të siguruar provat në mbështetje të pretendimeve, ka drejtuar shkresat zyrtare për të marrë informacionin e nevojshëm. Në kushtet kur informacioni i kërkuar disponohet nga institucione publike, të qeverisjes, qendrore dhe vendore është i vështirë për tu siguruar kërkojmë nga ana juaj të administroni të plotë dokumentacionin shkresor dhe filmik në fjalë duke e kërkuar drejtpërdrejt nga institucioni pranë të cilit gjendet.

Përveç shkeljeve të ligjit të konsumuara gjatë procesit në QV-të e sipërcituara në këtë zonë zgjedhore janë konsumuar edhe shkelje të rënda të ligjit zgjedhor në procedin e votimit.

Ne kemi identifikuar një seri punonjësish të administratës publike që janë përfshirë në Kamëz në ndikim dhe intimidim të zgjedhësve. Më poshtë, gjeni listën e punonjësve të



administratës publike dhe të ndonjë përsone tjetër të cilët kanë ndikuar dhe intimiduar zgjedhësit me datë 14.05.2023.


Nr.	Emër, Mbiemër	Pozicioni	QV-ja
1	Shpetim Leskaj	Dr. Licensave bashkia Kamëz	1574
2	Blerim Matoshi	Zjarrfikës, bashkia Kamëz	1574
3	Adjen Markola	Ministria e Mjedisit	1576
4	Defrim Cani	Shkolla Profesionale Kamëz	1576
5	Ramadan Hysa	Kadastra bashkia Kamëz	1576
6	Skender Biba	ASHK	1588, 1589
7	Eris Martini	Drejtues UKKamez	1588, 1589
8	Gjon Leti	Pergj. Task Force UKKamez	1573
9	Fation Lleshi	Pergj. Sektori bashki Kamez	1573
10	Saimir Kurti	Pergj. OSHE	1573
11	Bardh Deda	UKKamez	1573
12	Zelie Muceku	UKKamez	1573
13	Artan Koleci	Nd. Pastr. Gjellberimi Kamez	1573
14	Agim Koleci	Jurist bashkia Kamez	1573
15	Ergi Kuka	ASHK	1573
16	Ilir Bami	Zjarrfikës bashkia Kamez	1573
17	Artur Algjoni	Punonjes bashkie	1579
18	Eni Bistri	Drejtor i Tatim Taksave	1571
19	Lulzim Kaca	Punonjes Bashkie	1579
20	Klodian Çupi	Punonjes bashkie Diber	1579
21	Eronit Lama	Keshilltar i Kryetarit te bashkise	1588, 1589
22	Migena Habibi	Zv. Kryetare bashkise	1581, 1586
23	Rasim Beluli	Drejt. Shk. 100 Vjetori	1584, 1585
24	Kamber Beluli	Task forca UKK	1598, 1599
25	Durim Cani	Qendra shendetesore	1586
26	Elona Rama	Mesuese	1586



27	Festim Tarko	Nd.Pastr.Gjelb kamez	1586
28	Ritan Lleshi	Roje shkolle	1586
29	Korab Kola	Zjarrfikes	1586
30	Agim Hoxha	Punonjes shkolle	1586
31	Sokol Vatnikaj	Punonjes UKKamez	1586
32	Flora Muça	Drejt. Investimesh b. Kamez	1586
33	Luftar Kurti	Specialist Sporti b. Kamz	1586
34	Arjana Cani	Zyra arsimit b. Kamez	1586
35	Fatjon Leksinaj	Specialist Dr. Licensave	1586
36	Kujtim Gjoni	Drejt. Shk. Ibrahim Basha	1586
37	Gentian Murataj	Drejt. Kadastra b. Kamez	1598
38	Lumturie A. Kurti	Drejt. Shk. Azem Hajdari	1586
39	Lumturie Ibrahimimi	Drejt. Shk. Sulejman Elezi	1586
40	Dajana Topuzi	Punonjese bashkia Kamez	1581
41	Antigona Lleshi	Punonjese bashkia Kamez	1581
42	Bleona Burnazi	Punonjese bashkia Kamez	1581
43	Aulon Peto	Punonjes UKKamez	1581
44	Ermir Shahini	Drejtues OSHE	1581
45	Ernis Jana		1581
46	Thellenza Hoxha	Punonjese UKKamez	1581
47	Florin Uka		1581
48	Urim Çajka	IVMT bashkia Kamez	1564, 1565
49	Akil Sokolaj	Pergjegjes OSHE	1564, 1565
50	Emanuela Neçi	Pergj. Njesia Valias	1579
51	Albert Laçi	K. inspektor IVMT	1579
52	Mia Dragjoshi	UKKamez	1579
53	Shkelqim Neçi	Kryetar fshati	1579
54	Bashkim Rusi	Jurist b. Kamez	1579
55	Bleona Manjani	Kadastra b. Kamez	1579



56	Halil Halmusaj	Sherbimet publike b. Kamez	1579
57	Lulzim Shpata	Zjarrfikes b. Kamez	1579
58	Fation Braka	UKKamez	1564, 1565
59	Kozeta Ndreka	Tatimet b. Kamez	1579
60	Albert Çupi	UKKamez	1579
61	Flamur Rexha	UKKamez	1579
62	Bilbil Lleshi	UKKamez	1579
63	Rajmonda Nikolli	Drj. Ndhmës Ekonomike	1571
64	Florentin Çajka	Drejt. Rindert. B. Kamez	1564, 1565, 1584, 1585
65	Eriona Seli	Njes.Adm. Bathore	1564, 1565, 1584, 1585
66	Dorisiana Hasani	Punonjese ne ministri	1564, 1565, 1584, 1585
67	Mahmut Ajazi	Drejt. Shk. Halit Coka	1564, 1565, 1584, 1585
68	Bukurie Ajazi	Mesuese	1564, 1565, 1584, 1585
69	Hafuz Doda	Nd.Pastr.Gjelb	1564, 1565, 1584, 1585
70	Eva Muja	IEVP f. Kruje	1564, 1565, 1584, 1585
71	Hysen Çajka	Biznes privat	1564, 1565, 1584, 1585
72	Dyla Vukzaj	Drejt. Shkolle	1564, 1565, 1584, 1585
73	Nexhmie Cara	Drejtore kopshti	1564, 1565, 1584, 1585
74	Eueda Shkalla	Njes. Bathore	1600
75	Alda Hyseni	Njes. Bathore	1600
76	Hike Vladi	Njes. Bathore z.gj.civile	1600
77	Esmeralda Hysa		1600
78	Rebeka Sulejmani	Zv. Kryetare bashkie	1566, 1567
79	Blerta Matraku	Kryet. Njesie administer	1566, 1567
80	Migena Qerimi	Pergj. Taksat b. Kamez	1566, 1567
81	Rajmonda Leçka	Sekretare Kryet. B. Kamez	1566, 1567
82	Roland Baballeku	Drejt. Urbanistike b. Kamez	1566, 1567
83	Jamdiella Çipa	Zv. Drejt. Laprake	1566, 1567
84	Petrit Marku	Kryt. Njesia Valias	1572



85	Bardhyl Gjana	Shef PMNZSH	Paskuqan 2
86	Sait Suli	Biznes privat, vellai I R. Sulit	Paskuqan
87	Shkelqim Aliaj	Biznes privat	1579
88	Ylli Shehu	Kryet. Njesia Administ. Bathore	Bathore
89	Eduart Bodini	Kryet. Njesia Paskuqan	Paskuqan
90	Alda Cerpja	N/Kryetare e Bashkisë	1600
91	Admir Neza	Specialist i Shërbimeve	1600
92	Lefter Suli	IKMT	1600
93	Hane Nika	Specialist IT	1600
94	Ilmi Suli	Ndërmarrje Pastrim Gjelbërim	1600
95	Tafil Daci	Bashkia Tiranë	1600
96	Adhurim Ademi	Inspektor Tatimesh	1600
97	Fatbadha Pasha	Përgjegjëse e Arsimit	1571
98	Florinda Sefa	Policia Bashkiake	1571

Në pamjet tona filmike ka shumë punonjës të Bashkisë dhe institucioneve të tjera që kanë kryer shkelje të detyrimeve të Kodit Zgjedhor por edhe vepra penale të parshikura të dënueshme si krime zgjedhore.

Në Bashkinë Kamëz, në ambientet e qendrave të votimit, të kopshtit “Lulet e jetës”, drejtori i shkollës “100 vjetori”, Rasim Beluli, qëndron gjithë kohës, duke shoqëruar njerëz dhe duke kontrolluar dhe orientuar votat e tyre.

Bashkëngjitur foto





Nënkryetarja e Bashkisë Kamëz, Migena Habibi, ka qenë e pranishme gjatë gjithë ditës, në ambientet e brendshme tek qendrat e votimit, duke pritur dhe përcjellë deri tek kuti e votimit qytetarët, për ti kontrolluar dhe për tu siguruar që do të votojnë Rakip Sulin. Praktika e intimidimit dhe kontrollit të zgjedhësve për ti detyruar të votojnë kandidatët e partisë në pushtet, ka qenë një konstante në çdo qendër votimi në çdo cep të Shqipërisë, duke shkelur haptazi publikisht dhe me arrogancë, dispozitat e legjislacionit në fuqi, veçanërisht atij zgjedhor, që në mënyrë të detajuar përcakton kushtet për tu respektuar që zgjedhësi i të votojë i lire, deri tek duke vendë vendosur kufirin e militantëve jo më afër se 150m nga qendra e votimit.

Rasti i kësaj zyrtareje të lartë të Bashkisë Kamëz, ilustron më së miri faktin se zgjedhësit nuk kanë qenë të lirë, por nën presionin dhe kontrollin e vazhdueshëm, të zyrtarëve, të cilët i kanë detyruar të votojnë kandidatët e Bashkisë në pushtet.



A handwritten signature in blue ink.

Pavarësisht legjislacionit tejet të detajuar mbi vendosjen e materialeve propagandistike elektorale duke përcaktuar distancën e tyre nga qendra e votimit, Kryetari i Bashkisë Kamëz, Rakip Suli, ka vazhduar të mbajë deri në ditën e fundit, zyrën e tij elektorale të brenduar me materiale propagandiste, më fytyrën e tij. Rasti bëhet edhe më flagrant kur ligji detyron pikërisht bashkitë dhe drejtuesit e tyre të sigurohen që kjo të mos ndodhë.

Shkeljet flagrante si kjo, të kryera haptazi, publikisht, në shpërfillje të ligjit, kanë qenë tejet shqetësuese pasi ka vendosur votuesit në një situatë vulnerabël ndaj presionit të pushtetarëve, të cilët dëshmonin me arrogancë se janë edhe mbi ligjin.



Në qendrën e votimit 2041/1, në njësinë administrative Paskuqan, Bashkia Kamëz, përfaqësuesi socialist, Saimir H. Laçi, në komisionin e votimit, është vendosur në një pozicion të tillë që të jetë në gjendje të kontrollojë votën e çdo votuesi. Fotot bashkëngjitur tregojnë se ndërsa një votuese po voton, përfaqësuesi socialist, pa u ngritur nga vendi, jo vetëm që po komunikon me të, por është në gjendje që të shohë se cilën po voton, përmes biletës së printuar brenda në kuti, gjatë procesit të votimit elektronik.



Alessia Gecaj, punonjëse e Bashkisë Kamëz, dhe Elona Rama, mësuese në shkollën profesionale, janë raportuar se kanë ndenjur gjatë gjithë ditës së votimit në hyrjen e qendrës së votimit 1586, tek kopshti nr. 12 “Topolino”, së bashku me Durim Canin, shefi financës tek qendra shëndetësore Kamëz, Sokol Vatnikaj, përgjegjës sektori tek Ujësjellës-Kanalizime dega Kamëz dhe Albert Xhafa, shefi i financës ujësjellës-kanalizime Kamëz, i cili nuk është komisioner në këtë qendër votimit. Raportohet se ky grup militantësh, të gjithë punonjës të administratës, kanë shoqëruar punonjësit nga jashtë qendrave të votimit, deri tek dhomat e votimit, ku janë marrë nga përfaqësuesit e partisë në pushtet brenda në QV, e përsëri përcjellë deri jashtë, duke mundur të orientojnë votuesit dhe duke i privuar nga liria për votuar të lirë dhe të pa ndikuar

Provat Foto bashkëlidhur, video Kopeshti Topolino dhe Topolino 1



Tek qëndrat e votimit në shkollën “Elez Isuf Ndreu” kanë qenë prezent gjatë gjithë ditës së votimit punonjës të ndryshëm të administratës, Ylli Shehu administrator i njësisë bashkiake Bathore, Rigelsa Gupe, drejtoresh e pallatit të kulturës, Drita Gërbolli, Drejtoresh e Kopshteve, gjate gjithë ditës kanë qenë në QV te kjo shkollë, duke orientuar votuesit dhe duke kontrolluar votat e tyre. Kanë shoqëruar votuesit në mënyrë stafete që nga ambientet e jashtme votuesit, dhe kanë ndjekur gjithë procedurën e votimit deri tek përcjellja jashtë QV.





Një natë përpara zgjedhjeve të datës 14 Maj 2023, punonjës të policisë së shtetit të ardhur nga Forca Shqiponja, Forca të ndërhyrjes së shpejtë, kanë ndaluar dhe kontrolluar dhe penguar çdo drejtues shtabi, kryetar grup seksioni të Partisë Demokratike duke mos i lejuar ata të ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, po ashtu nuk kane shoqëruar asnjë nga targat e denoncuar nga an e anëtareve të PD dega Kamëz, të dyshuar për blerje votash, si p.sh. Bashkim Gjoka, koordinatori i PD për zonën e Bathores, Luan Xhika nënkryetari i PD dega Kamëz dhe njëkohësisht kryetari i grup seksionit nr. 7, Besnik Pasha, ish administratori njësisë administrative Bathore dhe aktualisht Kryetari i grupseksionit nr. 6 Bathore, Shefqet Sefa, kryetar i seksionit nr. 6, Bathore, Francesk Muca, kryetari i FRPD Dega Kamëz, etj.

Erlend Baballëku, drejtori i lejeve në bashkinë Kamëz, foto duke shoqëruar votues për të QV 1584/1, Kopshti "Halit Coka" bathore.



Tek QV 1577, Valias i vjetër, Bashkia Kamëz, raportohet votimi kolektiv si një fenomen shumë i përhapur.





Babrru, QV 2051/0, operatorja është fotografuar teksa është prezent në momentin e votimit duke mos lejuar që votuesi të votoj në fshehtësi.



Vëzhgues të PD zyrtare, por në fakt kanë qënë anetare dhe aktivistë të PS, si Hysen Koldashi, Kryetar i këshillit Bashkiak të PS, Pal Aliaj, përgjegjës i ujësjellsit Kamëz.

Te punesuarit ne Bashki:

Gentjan Bicuku – Drejtor i pastrim gjelbërimit

Pal Aliaj - Kryetar i këshillit Bashkiak të PS

Pëllum Peposhi – specialist tek Ujësjellës-Kanalizime dega Kamëz

Valdet Peposhi – INUV i Bashkisë

Bekim Puci - Zjarrëfikës

Admir Peposhi- Zjarrëfikës

Edison Troci – Shërbimet Publike

Ndriçim Marku - specialist tek Ujësjellës-Kanalizime dega Kamëz

Nertila Ndreu - Zv kryetarja Qarkut



Ferim Hasanaj - kadastër

Vëzhgues të PS nën siglën e PD

Pal Alia

Hysen Koldashi

Komisioner të PS nën siglën e PD

- Hajredin Bresa vëllai i këshilltarit të Bashkisë Dritan Bresa.

Në rast se hapen dhe analizohen pamjet filmike që do tju dërgojmë ne dhe ato që kanë regjistruar serverat e QV do të konstatohen shume individ që kanë konsumuar në mënyrë të dukshem këto element të veprave penale në fushën e krimeve zgjedhore.

Duke marrë shkas nga të dhënat e vëzhguesve dhe të numëruesve në GNV, Koalicioni Bashkë Fitojmë, kërkon marrjen e provës nga KQZ të pajisjes me regjistrimet e kamerave të procesit të numërimit në Bashkinë Kamëz. Nga verifikimi i këtyre pamjeve filmike do të rezultojë anomali apo parregullsive në kualifikimin jo të rregullt të votës, kjo sipas evidencave dhe sipas konstatimit të pamjeve filmike pasqyruar në QV-të e ZAZ.

Pra, natyra e shkeljeve të pretenduara në procesin e leximit dhe vlerësimit të votës, e bëjnë të detyrueshme këqyrjen e materialit zgjedhor me qëllim final përsëritjen e zgjedhjeve zgjedhjeve për Kryetar të bashkisë si dhe të Këshillit Bashkiak Kamëz me anë të votimit tradicional me fletë votimi dhe me garanci të plota për një proces të rregullt sipas standarteve të Bashkimit Europian.

Ne lidhje me procesin ne disa QV pjese e Bashkise Kamëz, po sjellim shembullin e QV nr. 1575/0 dhe 1579/2 te cilat nuk jane perfshire ne rezultat pasi nga KZAZ nr. 27 Kamëz eshte marre vendimi qe te mos perfshihen ne rezultatin perfundimtar.

Tek shkeljet ligjore nuk mund te lene pa permendur edhe mos-rakordimin e shifrave te fleteve te votimit te kandidateve me ato per Keshillin Bashkiak Kamëz, ku edhe nga tabelat e miratuara nga vete KSHZ, me vendimin e tij objekt ankimi, rezulton fare e qarte se nuk ka perputhje midis shumave totale te votave. Me konkretisht, nga njera ane tabela perblemese e votave per kandidat bashkie del ne total **46.746**, kurse per keshillin bashkiak, figurojne **46.494** vota te gjendura ne kutite e votimit elektronike. ***Si ka mundesi qe te kete mosperputhje shifrash lidhur me kete rast, ne kushtet kur votimi ishte totalisht elektronik dhe votimi nuk mbyllet pa u votuar edhe ne keshill ?***

Për të përforcuar këtë qëndrim të bazuar të Koalicioni ankues, në interesin më të lartë të procesit zgjedhor që ka të bëjë me numërimin e votave të kësaj Bashkie, janë administruar tabelat përmbledhëse dhe libri i protokollit të mbledhjeve të KZAZ-se si dhe cdo dokument tjetër që vërteton pretendimet tona. Nga këto dokumente konstatohet se nga përmbajtja e vendimmarjeve të çdo KZAZ-je rezultojnë parregullsi të shumta të cilat kanë cenuar procesin e votimit, të numërimit, të identifikimit korrekt të votës, nëpërmjet ndërhyrjeve që janë bërë me qëllim tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve të kësaj zone zgjedhore.

Këto veprime vijnë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe procedurat e caktuara në aktet e Komisionit Rregullator pranë KQZ dhe të Komisionerit Shtetëror të



Zgjedhjeve për sa i përket pasqyrimin real dhe të vërtetë të vullnetit të zgjedhësve. Kjo rrethanë përbën shkak ligjor sipas parashikimeve të nenin 160 dhe provon se vendimi që në kundërshtojmë dhe gjithë procedura e mëpasshme që përfundon me miratimin e tabelës përmbledhëse nga KQZ janë marrë në kundërshtim të hapur me ligjin.

Ankuesi kërkon nga KAS që për nevoja të hetimit administrativ, ky organ kolegjal të vendosi të administrojë si prova Librin e Protokollit të Mbledhjeve, Proces-Verbalet e Konstatimit, filmimet e kamerave të KZAZ-ve objekt ankimi, tabelat e rezultatit të grupeve të numërimit për QV të e cituara na ankim, pamjet filmike të VNV-ve, QV-VE dhe vetë ZAZ-së si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për një hetim administrativ të plotë dhe të paanshëm, **perfshire dokumentacionin teknik dhe dokumentacionin e penetrimit te pajisjeve elektronike te votimit.**

Pavarësisht dokumentacionit të sipërpërmendur, materiali zgjedhor që do të nxirret nga pamjet filmike në shumë raste krijon dhe do të krijoj dyshime të arsyeshme se vlerësimi i votës nuk është bërë në mënyrë të drejtë.

Gjithashtu, Ankuesi vlerëson se transparenca në lidhje me procesin e votimit, numërimin dhe vlerësimin e votave për zonën zgjedhore Bashkia Kamëz, ka një rëndësi të madhe për besueshmërinë e procesit zgjedhor dhe për integritetin e tij, nisur nga procesi elektronik i votimit. Për sa koha Koalicioni nga dokumentacioni ka konstatuar parregullsi, lindin dyshime të arsyeshme se në disa qendra votimi objekt ankimi, vota nuk është vlerësuar saktë, nuk ka shkuar aty ku ishte vullneti i zgjedhësve, dhe nevoja imediate që lind për transparencë të procesit të numërimit për këto Qendra Votimi, duhet domosdoshmërisht të bindi anëtarët e KAS të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet e paraqitura nga Ankuesi nëpërmjet rinumërimit dhe rivlerësimit të votave në kutitë e votimit të qendrave të votimit, Bashkia Kamëz, sipas parashtrimeve të Kërkesës Ankimore.

Në përputhje me parashikimet e nenit 136, pika 3 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet shprehimisht se: **“Kërkesa për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, kur mbështetet nga dy anëtarë të KQZ-së dhe kur këto prova administrohen vetëm nga KQZ-ja, pranohet menjëherë pa iu nënshtruar debatit ose votimit në KQZ. Në këtë rast organi shqyrtues i Ankimit, pra KAS është i detyruar të procedojë menjëherë me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkuara”,** dhe në përputhje me parashikimet e nenit 138 “Këqyrja e materialit zgjedhor” të Kodit Zgjedhor, **KAS me vendim të ndërmjetëm duhet të vendosi të kryejë rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në QV-të sipas objektit të ankimit.**

Për sa i përket këtyre shkeljeve, të cilat i provojmë me prova shkresore, fotografi si dhe pamjet filmike ku janë shkelur në mënyrë flagrante nenet 116, 117, 118, 119 e vijues të Kodit Zgjedhor, KQZ bazuar në material provues të rivlerësoje votat në qendrat e votimit të kërkuara më sipër. Pasi te kryhet rinumërimi dhe rivlerësimi i këtyre kutive të votimit, KQZ të hartojë dhe të miratojë tabelën përmbledhëse përfundimtare duke shfuqizuar vendimin nr. 536 datë 20.05.2023 të KSHZ, lidhur me miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit në Bashkinë Kamëz.



NË LIDHJE ME PAVLEFSHMËRINË E ZGJEDHJEVE

Kodi Zgjedhor ka përcaktuar në mënyrë të detajuar cilat janë rastet kur zgjedhjet shpallen të pavlefshme, cili është organi kompetent dhe pasojat që sjell një vendim i tillë. Konkretisht, neni 160 parashikon se KQZ-ja i shpall zgjedhjet të pavlefshme kur tërësia e shkeljeve të ligjit mund të ketë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Një vendimmarrje e tillë, sipas neni 121, pika 1 është kompetencë ekskluzive e KAS-it. Në rast të marrjes së një vendimi për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një zonë zgjedhore, neni 161, pika 1 parashikon se KQZ-ja urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore.

Pavlefshmëria e zgjedhjeve është mjet ligjor në duart e subjekteve ankuese, i cili mundëson anulimin e votimit/rezultatit dhe përsëritjen e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi. Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si shkaqe për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve: a) shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor ose tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore; b) fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose c) mosfillim i votimit apo pezullim i tij për më shumë se pesë orë. 3. Shkaqet sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës pararendëse kanë lidhje vetëm me procesin e votimit, kurse shkaqet sipas shkronjës “a” kanë lidhje me procesin në përgjithësi (përfshirë votimin dhe rezultatin e zgjedhjeve).

Kodi Zgjedhor lejon si shkak për pavlefshmërinë një tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Në dallim nga shkakun themelor, ky rast kërkon më shumë se sa një shkelje, me një shkallë më të ulët cënimi. Në këtë rast nuk duhet që të ketë pasur pengim/largim të zgjedhësve në masë nga votimi, detyrim të tyre që të votojnë në masë kundër vullnetit, apo tjetërsim në masë të votës së hedhur, por mjafton që ky fenomen (pengimi/largimi i zgjedhësve nga votimi, detyrimi për të votuar kundër vullnetit, apo tjetërsimi i votës) të ketë ndodhur në atë shkallë, sa të mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve. Edhe në këtë rast, kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik pse shkelja e pretenduar është “shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve”, si dhe me provën për përmasën e ndikimit dhe lidhjen shkakësore.



Kriteri ligjor për matjen e ndikimit përcaktohet nga neni 161 i Kodit dhe është gjithmonë numerik. Sipas pikës 2 të këtij neni “ndikim në ndarjen e mandateve në zgjedhjet për kryetar

të qeverisjes vendore do të konsiderohet kur numri i zgjedhësve në qendrat e shpallura të pavlefshme është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme.

Në këtë rast faktet dhe provat te cilat për pamundësi objektive nuk mundëm ti sigurojmë por ti evidentojmë qarte, për tu kërkuar institucionalisht nga KQZ, përmbushin kushtin se provat ekzistojnë përpara pretendimit, nuk krijohen për shkak të tij.

Shkeljet e pretenduara, që shërbejnë si indicia për rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në Qendrat e votimit të njësisë zgjedhore Bashkia Kamëz.

Duke marrë shkas nga të dhënat e vëzhguesve dhe të numëruesve në GNV, Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, kërkon marrjen e provës nga KQZ të pajisjeve me regjistrimet e kamerave të procesit të numërimit në Bashkinë Kamëz. Natyra e shkeljeve të pretenduara në procesin e leximit dhe vlerësimit të votës, e bëjnë të detyrueshme rinumërimin dhe rivlerësimin për ato qendra votimi, ku nga informacionet që disponojmë konstatohet qartë se vota e Kandidatit të Koalicionit është shpërdoruar dhe për pasojë nuk është vlerësuar në mënyrë korrekte nga grupet e numërimit.

Në përputhje me parashikimet e nenit 136, pika 3 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet shprehimisht se: *“Kërkesa për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, kur mbështetet nga dy anëtarë të KQZ-së dhe kur këto prova administrohen vetëm nga KQZ-ja, pranohet menjëherë pa iu nënshtruar debatit ose votimit në KQZ. Në këtë rast organi shqyrtues i ankimit, pra KAS është i detyruar të procedojë menjëherë me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkuara”*, dhe në përputhje me parashikimet e nenit 138 “Këqyrja e materialit zgjedhor” të Kodit Zgjedhor, KAS me vendim të ndërmjetëm duhet të vendosi të kryejë rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në QV-të sipas objektit të ankimit.

Për sa i përket këtyre shkeljeve, të cilat i provojmë me pamjet filmike ku janë shkelur në mënyrë flagrante nenet 116, 117, 118, 119 të Kodit Zgjedhor, KQZ bazuar në material provues të rivlerësoje votat në qendrat e votimit të kërkuara më sipër. Pasi te kryhet rinumërimi dhe rivlerësimi i këtyre kutive të votimit, KQZ të hartojë dhe të miratojë tabelën përmbledhëse përfundimtare duke shfuqizuar vendimin nr. 532 datë 18.05.2023 të KQZ.

Në vlerësimin tonë ka prova të mjaftueshme për të disponuar sipas objektit të kërimit.



KONKLUZION

Sa më sipër kërkojmë:

1. Kundërshtimin e Vendimit Nr. 536, datë 20.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në Zonën Zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023” ;
2. Ekspertimin kompjuterik të çdo pajisjeje elektronike që është e pajisur me server për ruajtjen e të dhënave elektronike. Kjo të realizohet nga ekspertë të huaj të pavarur nga institucionet shtetërore apo Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Për këtë nevojitet që pajisjet të ruhen në kushte të përshtatshme në gjendjen aktuale me qëllim mosndërrhyrjen nga personat e paautorizuar si dhe të mirëruajtura nga agjentët atmosferikë.
3. Krahasimin e rezultatit elektronik të zgjedhjeve me rezultatin fizik (fletëve të votimit të gjendura në kuti) për çdo qendër votimi. Për këtë kërkohet një process sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.
4. Kqyrjen e kamerave të jashtme dhe të atyre të përdorura brenda qendrave të votimit me qëllim evidentimin e të gjithë personave të paautorizuar apo pjesë e administratës vendore dhe qëndrore në nivel specialist apo drejtuesi, që kanë qënë gjatë gjithë kohës nëpër qendra votimi, evidentimin e mosnënshkrimit të deklaratave përkatëse për votuesit që janë shoqëruar, evidentimin e votimit nga vetë Operatorët e PEVN-ve, evidentimin e votimit të komisionerëve për llogari të votuesve.
5. Krahasimin e kodeve të votuesve me listen e votuesve për çdo QV në Bashkinë Kamëz, në lidhje me pajisjen e identifikimit të votuesve (PEI).
6. Rinumërimin dhe Rivlerësimin e votave në të gjitha qendrat e votimit të njësisë zgjedhore, Bashkia Kamëz dhe miratim i tabelës përmbledhëse për zonën zgjedhore Bashkia Kamëz duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave;
7. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz; si dhe
8. Së fundmi, pasi të jenë kryer veprimet e mësipërme dhe të keni krijuar bindjen Tuaj institucionale se kjo nuk është vota e qytarëve, nga ana Juaj kërkojmë:

Përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar të bashkisë si dhe të Këshillit Bashkiak Kamëz me anë të votimit tradicional me fletë votimi dhe me garanci të plota për një process të rregullt.

**PROVAT QË PARAQITEN
DHE /OSE KËRKOHEN, BURIMIN SI DHE NUMRI I TYRE.**

1. Vendimi nr. 536 datë 20.05.2023 i KSHZ objekt ankimi ;
2. Provat e tjera të paraqitura në seancë.



Me Autorizim

Përfaqësuesi i Ligjor i Koalicionit
"BASHKË FITOJMË"

Franci NALICI

Tiranë, 23/05/2023

